



Prishtinë, 24 tetor 2013
Kodi i ZRRE-së: V_572_2013

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, 5 dhe 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenin 14, nenin 15 paragrafi 1 dhe nenin 16 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja; dhe
- Kërkesën/Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, me kapacitet të instaluar prej 9.33 MW që përbëhet prej gjashtë (6) njësi gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: HC Brod I. 1062 kW; Brodi II.(Dikancë) 1250 kW; Brod III.(Kukalane) 3120 kW; (totali 5432 kW) dhe Restelica I. 1200 kW; Restelica II.(Krushevë) 1200 kW; Restelica III.(Globoqicë) 1498 (Totali 3898 kW), të gjitha në komunën e Dragashit, të datës 29.09.2011 të ndërmarrjes “Eurokos J.H.” SH.P.K. & Loreto Consult AG, me adresë rruga 20 “Zenun Beqa”, Ferizaj, Republika e Kosovës,
- Kërkesën për shëndrrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, për HC Brodi II. me kapacitet të instaluar prej 1.25 MW dhe HC Restelica II. me kapacitet të instaluar prej 1.2 MW, në komunën e Dragashit, të datës 07.08.2013 të ndërmarrjes “Eurokos J.H.” SH.P.K. & Loreto Consult AG, me adresë rruga 20 “Zenun Beqa”, Ferizaj, Republika e Kosovës.
- Kërkesën me ndryshime për shëndrrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, për HC Brodi II. me ndryshim të kapacitetit të instaluar nga 1.25 MW në 3.89 MW dhe HC Restelica I. dhe II. bashkohen me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, të datës 21.10.2013 të ndërmarrjes “Eurokos J.H.” SH.P.K. & Loreto Consult AG, me adresë rruga 20 “Zenun Beqa”, Ferizaj, Republika e Kosovës.
- Kontratat, lejet pëlqimet dhe vendimet e lëshuara nga institucionet përgjegjëse, si në shtojcë I. të këtij vendimi,

në seancën e mbajtur me datë 24 tetor 2013 nxori këtë:

V E N D I M

PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT

- I. I lëshohet AUTORIZIMI** ndërmarrjes “Eurokos J.H.” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC Brodi II.(Mlik) me kapacitet të instaluar prej 3.89 MW, në Lumin Brod dhe HC Restelica I dhe II.,(Krushevë) bashkohen në një objekt të hidrocentralit, me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, në Lumin Restelica, komuna e Dragashit.



- II. Për njësit tjera: HC Brod I. 1062 kW, Brod III.(Kukalane) 3120 kW dhe Restelica III.(Globoqicë) 1498 kW, të cilat janë pjesë të aplikacionit, do të shqyrtohen dhe vendoset pas sjelljes së Lejes Ujore për HC Restelica III., Lejet e Ndërtimit për të gjitha njësitë dhe kërkesat tjera sipas legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

- ZRRE me datë 29.09.2011 nga ndërmarrja “Eurokos J.H.” SH.P.K. & Loreto Consult AG, ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, me kapacitet të instaluar prej 9.33 MW që përbëhet prej gjashtë (6) njësite gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: HC Brod I. (Brod) 1062 kW; Brodi II.(Dikance) 1250 kW; Brod III.(Kukalane) 3120 kW; (totali 5432 kW) dhe Restelica I. 1200 kW; Restelica II.(Krushevë) 1200 kW; Restelica III.(Globoqicë) 1498 kW (Totali 3898 kW), të gjitha në komunën e Dragashit.
 - ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, me datë 10 shkurt 2012 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_395_2012, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
 - ZRRE me datë 07.08.2013 ka pranuar kërkesën për shëndrrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji në Autorizim për dy (2) njësit gjeneruese HC Brodi II. me kapacitet prej 1.25 MW dhe HC Restelica II. me kapacitet prej 1.2 MW, duke i bashkangjitur dëshmitë relevante.
 - ZRRE me datë 21.10.2013 ka pranuar kërkesën me ndryshime për shëndrrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, për HC Brodi II. me ndryshim të kapacitetit të instaluar nga 1.25 MW në 3.89 MW dhe HC Restelica I. dhe II. bashkohen në një objekt të hidrocentralit me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtat mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin ujit, Lejet ndërtimore dhe kërkesat tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
 - ZRRE, pas vlerësimit të dëshmime të bashkangjitura dhe pranimit të dëshmime tjera plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III. Vendimi për AUTORIZIM i lëshohet ndërmarrjes “Eurokos. JH” SH.P.K., për dy (2) vite, dhe obligohet që brenda kësaj periudhe të ndërtoj stabilimentet e reja gjeneruese nga Uji.



- IV. Ky vendim nuk i përfshin Njësitë: HC Brod I. 1062 kW, Brod III.(Kukalane) 3120 kW dhe Restelica III.(Globoqicë) 1498 kW, sipas Vendimit Nr. 395_2012 mbi Njoftimin për Autorizimit Preliminar të datës 10 shkurt 2012.
- V. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bashkangjitur Vendimit janë Shtojca I dhe Shtojca II.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtar

Krenar Bujupi, anëtar.



SHTOJCA I

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), duke ushtruar kompetencat e dhëna me nenin 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe në përputhje me Nenin 16 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e kapaciteteve të reja, ndërmarrjes “Eurokos. JH” SH.P.K., me adresë rruga 20 “Zenun Beqa”, Ferizaj, Republika e Kosovës, **i lëshon këtë:**

AUTORIZIM

1. Për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC Brodi II.(Mlik) me kapacitet të instaluar prej 3.89 MW dhe HC Restelica I. dhe II.(Krushevë) bashkohen në një hidrocentral me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, në komunën e Dragashit.
2. Me këtë Autorizim autorizohet ndërmarrja “Eurokos.JH” SH.P.K, që të ndërtojë kapacitetet gjeneruese në lokacionin e caktuar më lart, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Autorizim.
3. Me këtë Autorizim njësit: HC Brod I. 1062 kW, Brod III.(Kukalane) 3120 kW, dhe Restelica III.(Globoqicë) 1498 kW, nuk autorizohen pasi që ndërmarrja “Eurokos JH” SH.P.K., nuk ka bashkangjitur dëshmitë kryesore: Lejen Ujore për HC Restelica III., Lejet e Ndërtimit dhe kërkesat tjera sipas legjislacionit në fuqi.
4. Ky Autorizim do të vlejë për dy (2) vite, duke filluar nga data e lëshimit të tij. ZRRE, me kërkesë të palës, mund ta vazhdojë vlefshmërinë e Autorizimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Pala e Autorizuar, gjatë tërë periudhës së vlefshmërisë së këtij Autorizimi, duhet të plotësojë:
 - 5.1. të gjitha kushtet e përcaktuara me këtë Autorizim,
 - 5.2. të gjitha kushtet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi në Kosovë, përfshirë edhe ato për mjedisin.
6. Zyra e Rregullatorit për Energji mund ta bëjë modifikimin e këtij Autorizimi në përputhje me dispozitat e nenit 19 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
7. Në rast se pala e Autorizuar falimenton para se të ndërtohet stabilimenti gjenerues i autorizuar, atëherë ky Autorizim do të pezullohet dhe do të mbetet i tillë derisa ZRRE përcakton se janë arritur marrëveshje të kënaqshme që mund ndikojnë në tërheqjen e pezullimit. Derisa ky Autorizim është i pezulluar e tërë puna e mëtutjeshme në ndërtimin e stabilimentit gjenerues të Autorizuara duhet të ndërpritet. Në rast të kundërt ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.



8. Vlefshmëria e këtij Autorizimi automatikisht do të përfundojë me skadimin e afatit të përcaktuar në pikën II. të këtij Autorizimi, apo me skadimin e afatit tjetër të përcaktuara nga ZRRE në përputhje me pikën 2 të këtij Autorizimi.
9. Në rast se pala e Autorizuar bën shkeljen e ndonjëres prej kushteve të këtij Autorizimi apo bën shkelje të dispozitave ligjore të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja, ZRRE mund ta pezulloj Autorizimin në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulle. Nga data e pezullimit të Autorizimit e tërë puna e mëtutjeshme në stabilimentin e autorizuar gjenerues do të ndërpritet. Në rast të kundërt, ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara sipas legjislacionin në fuqi.
10. Pala e autorizuar duhet ta njoftojë me shkrim ZRRE-në dhe të kërkojë pëlqimin paraprak për çdo ndërrim të ndonjë pjese të elementeve ekzistuese të gjeneratorëve apo shtim të elementeve të reja, e që nuk janë të përfshira në aplikacionin fillestar.
11. Pas përfundimit të ndërtimit të stabilimenteve të reja gjeneruese dhe para lëshimit në punë të njësive gjeneruese, ndërmarrja **“Eurokos JH” SH.P.K.**, duhet të aplikoj për licencim sipas nenit 18 të Rregullës e Procedurën së Autorizimit dhe Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.



SHTOJCA II

Lista e dokumenteve (lejeve, pëlqimeve, vendimeve, kontratave, etj.), të lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës lidhur me marrjen e **Autorizimin** për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC Brodi II.(Mlik) me kapacitet të instaluar prej 3.89 MW dhe HC Restelica I dhe II.(Krushevë) me kapacitet të instaluar prej 2.28 MW, në komunën e Dragashit, lëshuar ndërmarrjes “Eurokos. JH” SH.P.K.:

- **Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm** për ndërtimin e tubacioneve të ujrave në një gjatësi prej katër (4) metrave nga vepra e marrjes e deri te Hidrocentralet, e lëshuar nga Kuvendi Komunal në Dragash 01 Nr.06-1281/1 dt. 08.08.2012.
- **Aktvendimi 06 nr. 351-1554 i datës 16.10.2013 lëshuar nga Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit KK Dragash**, për lejimin e ndërtimit të hidrocentralit “Brodi 2” në kuotën (Objekti i Hidrocentralit 945/25 me nr. të parcelës 1729) ZK Mlik dhe vepra e marrjes në kuotën 1114 me nr. të parcelës 1235 ZK Dikance, dhe ngastrat katastrale nr. 1235, 1235, 1235, 1235, 1217, 1235, 1217, 1235, 1735, 1235, 258 ZK Dikonc, 1729, 1729, 1226, 1729, 1729, 1729, 1145, 738, 1145, 714 ZK Mlik 368, 368 ZK Baqka - Dragash, sipas projektit teknik dhe dokumentacionit përkatës, me lartësi P+0.
- **Aktvendimi 06 nr. 351-1554 i datës 16.10.2013 lëshuar nga Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe mbrojtje të Mjedisit KK Dragash**, për lejimin e ndërtimit të hidrocentralit “Restelica I dhe II” në kuotën e veprave të marrjes (13.18.51) në parcelën 3771 deh kuotën (1318.51) me n.r të parcelës 3775 ZK Restelica, dhe objekti i hidrocentralit në kuotën (1170.85) në ngastrat katastrale nr. 714 ZK Krushevë dhe ngastrat katastrale nr. 3771, 1391, 1739, 3775 ZK Restelica dhe 1145, 738, 1145, 714 ZK Krushevë - Dragash, sipas projektit teknik dhe dokumentacionit përkatës, me lartësi P+0.
- **Vendim për Pëlqimi mjedisor** nr. 11/1765/2-ZSP-128/12 i datës 26.06.2012, për ndërtimin e hidrocentraleve gjeneruese “Brod I., II. dhe III., përgjatë Lumit Brod të Dragashit, lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- **Vendim për Pëlqimi mjedisor** nr. 11/1764/2-ZSP-127/12 i datës 26.06.2012, për ndërtimin e hidrocentralit gjenerues “Restelica II., përgjatë Lumit Restelicë të Dragashit, lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- **Vendim për Pëlqimi mjedisor** nr. 11/1764/3-ZSP-133/13 i datës 24.05.2013, për ndërtimin e hidrocentralit gjenerues “Restelica I. dhe III., përgjatë Lumit Restelicë të Dragashit, lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- **Vendim për Leje Ujore** nr. 1782-2/11-ZSP-621/12 i datës 23.08.2012, për Konzorciumin “Eurokos JH & Loreto Consult AG”, për shfrytëzimin e ujit për Hidrocentralin e vogël me kapacitet prej 1.25 MW, HC Brodi II., në Lumin Brod, Komuna e Dragashit.



- **Vendim për Leje Ujore** nr. 1782-2/11-ZSP-623/12 i datës 23.08.2012, për Konzorciumin “Eurokos JH & Loreto Consult AG”, për shfrytëzimin e ujit për Hidrocentralin e vogël me kapacitet prej 1.2 MW, HC Restelica II., në Lumin Restelicë, Komuna e Dragashit.
- **Vendim për Leje Ujore** nr. 1782-2/11-ZSP-484/13 i datës 20.06.2013, për Konzorciumin “Eurokos JH & Loreto Consult AG”, për shfrytëzimin e ujit për Hidrocentralin e vogël me kapacitet prej 1.2 MW, HC Restelica I., në Lumin Restelicë, Komuna e Dragashit.
- **Kontrata për ekzekutimin e punimeve** në ndërtimin e Hidrocentraleve Brod II. dhe Restelica II., e lidhur në mes të ndërmarrjes Eurokos sh.p.k. dhe Eurokos JH SH.P.K.
- **Kontrata për furnizim me turbina, dhe montimin e pajisjeve elektromekanike, hidromekanike dhe elektro energjetike** për hidrocentralet e vogla në Lumin Bord dhe Restelica në komunën e Dragashit, e lidhur në mes të ndërmarrjes Eurokos JH sh.p.k. dhe Bicakcic d.o.o.
- **Kushtet për Kyçe në rrjetin e Distribucionit** nr. 4459 dt.08.09.2011.

Vulosur me vulën e rëndomtë të ZRRE-së më: _____.

Nënshkrimi (në emër të Bordit të ZRRE-së)
